

Tregu i Punës 2019


Tiranë, më 04 Maj 2020 : Bazuar në vlerësimet e Anketës së Forcave të Punës, gjatë vitit 2019, numri i personave në forcën e punës është 1.430 mijë persona. Femrat përbëjnë 44,4 % të forcës së punës dhe meshkujt 55,6 %. Të punësuar janë 1.266 mijë persona, ku femrat përbëjnë 44,5 % të të punësuarve dhe meshkujt 55,5 %. Numri i të papunëve vlerësohet të jetë 165 mijë persona, ndër të cilët 44,0 % janë femra dhe 56,0 % janë meshkuj.

Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për popullsinë 15-64 vjeç është 69,6 %. Për meshkujt e moshës 15-64 vjeç shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 16,0 pikë përqindje më e lartë sesa për femrat.

Shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç është 61,2 %. Shkalla e punësimit për femrat është 54,4 % dhe për meshkujt 68,2 %. Hendeku gjinor në punësim për këtë grup-moshë është 13,8 pikë përqindje.

Sektori i shërbimeve dhe sektori bujqësor kanë përqindjen më të lartë të të punësuarve me përkatësisht 43,5 % dhe 36,4 % të të punësuarve gjithsej. Në vitin 2019, rezulton se 45,7 % e të punësuarve janë të punësuar me pagë, 32,3 % janë të vetë-punësuar (punëdhënës ose të vetëpunësuar pa të punësuar të tjerë) dhe 22,0 % janë punëtorë pa pagesë në biznesin e familjes.

Fig.1 Shkalla e papunësisë sipas grup-moshave, 2019



Shkalla zyrtare e papunësisë në vitin 2019, për popullsinë 15 vjeç e lart, është 11,5 % dhe shënon një ulje me 0,8 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2018. Për meshkujt, shkalla e papunësisë është 0,2 pikë përqindje më e lartë sesa për femrat.

Shkalla e papunësisë për të rinjtë e moshës 15-24 vjeç është 27,2 % (27,8 % për meshkujt dhe 26,3 % për femrat). Krahasuar me vitin pararendës, shkalla e papunësisë së të rinjve ka rënë me 1,1 pikë përqindje.

Në vitin 2019, të rinjtë e moshës 15-29 vjeç të cilët nuk janë të punësuar dhe nuk janë duke ndjekur shkollën apo ndonjë formim profesional përbëjnë 28,9 % të të rinjve gjithsej.

Fig. 2 Të rinjtë (15-29 vjeç) jo në punësim dhe as duke ndjekur shkollën, sipas statusit në tregun e punës, 2019



Burimi: INSTAT, Anketa e Forcave të Punës


Në grupin e të rinjve që nuk janë të punësuar dhe nuk janë as duke ndjekur shkollën apo ndonjë formim profesional, 36,5 % klasifikohen si të papunë. Pjesa tjetër, janë jashtë tregut të punës për arsye se janë ose të dekurajuar (12,7 %), ose duke përmbushur detyra dhe përgjegjësi familjare (18,1 %), ose për arsye të tjera (32,7 %).

Qarqet

Një analizë mbi baza rajonale, tregon që në vitin 2019, qarqet me shkallë punësimi më të lartë për popullsinë 15-64 vjeç janë: Berat (65,7 %) dhe Korçë (63,2 %). Ndërsa qarku me shkallë punësimi më të ulët është qarku Lezhë (41,7 %). Qarqet me shkallë papunësie më të lartë janë qarku i Lezhës (17,7) % dhe qarku i Vlorës (15,2 %).

Në vitin 2019, në qarkun e Tiranës, punësimi në bujqësi zë një përqindje shumë të vogël të punësimit gjithsej (7,3 %). Pjesa më e madhe e të punësuarve janë të angazhuar në sektorin e shërbimeve (66,3 %) dhe një peshë të konsiderueshme zë edhe industria (26,3 %).

Fig. 3 Struktura e punësimit sipas qarqeve dhe sektorëve të ekonomisë, 2019



Burimi: INSTAT, Anketa e Forcave të Punës

Pagat

Në vitin 2019, paga mesatare mujore bruto në Shqipëri është 52.380 lekë lekë. Krahasuar me vitin 2018, paga mesatare mujore bruto për një të punësuar në Shqipëri u rrit me 3,5 %.


Paga mesatare mujore bruto është mbi nivelin mesatar për aktivitetet ekonomike si: Aktivitetet financiare dhe të sigurimit, Informacioni dhe komunikacioni, Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm; arsimi; shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale.

Ndërsa aktivitetet ekonomike me pagë poshtë nivelit mesatar janë: Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorçikletave; transporti dhe magazinimi; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor; dhe Bujqësia, Silvikultura dhe Peshkimi.

Hendeku gjinor në paga është 10,1 %. Hendeku gjinor në paga është më i theksuar mes punonjësve të punësuar në ndërmarrjet ekonomike që i përkasin grup-aktivitetit ekonomik “Industria nxjerrëse; përpunuese; energjia elektrike, gaz, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar; furnizimi me ujë; aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, rehabilitimit”, ku arrin vlerën 34,6 %.

Gjatë vitit 2019, 27,9 % e kontribuesve në kategorinë e të punësuarve me pagë marrin një pagë mesatare mujore bruto deri në nivelin e pagës minimale zyrtare. Për vitin 2019, paga minimale zyrtare është 26.000 lekë.

Fig.4 Shpërndarja e kontribuesve të punësuar me pagë sipas grupimeve të pagës mesatare mujore bruto, 2019



Burimi i informacionit: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kontribuesit në Sigurime Shoqërore; Llogaritje të INSTAT

Në vitin 2019, grup-profesionet më të paguara janë: Ligjvënësit, nëpunësit e lartë të administratës shtetërore dhe drejtorët ekzekutivë; Specialistët me arsim të lartë (profesionistë); dhe Teknikët dhe specialistët në zbatim. Ndërsa grup-profesionet me pagë nën nivelin mesatar janë: Punonjës të kualifikuar të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit; punëtorët e profesioneve elementare; dhe zejtarët, artizanët dhe profesione të lidhura me to.

Metodologjia

Shkalla e punësimit: Numri i personave të punësuar në moshë 15 deri 64 vjeç pjesëtuar me popullsinë në moshë 15 deri 64 vjeç.

Shkalla zyrtare e papunësisë: Numri i personave të papunë të moshës 15 e lart pjesëtuar me numrin e personave në forcën e punës (të punësuar e të papunë) të moshës 15 vjeç e lart.

Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës: numri i personave në moshë 15 deri 64 vjeç në forcën e punës pjesëtuar me numrin e popullsisë në moshë 15 deri 64 vjeç.

Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës dhe shkalla punësimit llogariten për popullsinë e moshës 15 deri në 64 vjeç. Ndërsa shkalla e papunësisë llogaritet për popullsinë ekonomikisht aktive (ndryshe forca e punës) të moshës 15 vjeç e lart. Shkallët e punësimit dhe të pjesëmarrjes në forcat e punës të llogaritura mbi popullsinë 15 vjeç e lart ndikohen nga përfshirja e personave në pension në emërues dhe kështu janë më pak kuptimplotë sesa shkallët e llogaritura për popullsinë e moshës 15-64 vjeç. Ndërsa, në llogaritjen e shkallës së papunësisë për popullsinë 15 vjeç e lart, në emërues kemi popullsinë ekonomikisht aktive, e cila përfshin personat e punësuar ose në kërkim aktiv të një pune dhe të aftë për punë, dhe si rrjedhojë ky tregues nuk ndikohet nga popullsia mbi moshën e pensionit.

Paga mesatare mujore bruto llogaritet për të punësuarit kundrejt pagës dhe përfshin: pagën bazë, shtesat mbi pagë për – (a) funksione drejtuese; (b) vjetërsi në punë; (c) vështirësi në punë; dhe (d) shtesa të tjera të rregullta (tituj, grada, etj). Në pagën mesatare bruto nuk zbriten kontributet personale dhe tatimi mbi të ardhurat.